



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.132 dt.05.08.1997

**PER
MIRATIMIN E FONDIT PER ADAPTIM ZYRASH DHE
BLERJE APARATE FOTOKOPJUES.**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.05.08.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme për rikonstruksionet e zyrave dhe blerjen e tre aparateve fotokopjues, mbështetur në ligjin “Për buxhetin lokal” me Nr.7616, dt.30.09.1992

VENDOSI

1. Të miratojë fondin për rikonstruksionin dhe adaptimin e ish Shtëpisë së Rinisë në Rrugën “Mihal Grameno” për zyra të Njësave Administrative në shumën 1.000.000 lekë.
2. Të miratojë fondin prej 1.000.000 lekë për blerjen e aparateve fotokopjues për nevojat të Bashkisë së Tiranës.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi, konform ligjeve në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

